

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale per pastrim ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Blerje materiale per pastrim –sapun-33711900-6,leter higjenike-33760000-5 etj.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 1. Fondi limit : 1.099.930 (nje milion e nente dhjete e nente mije e nente qind e tri dhjete) leke pa t.v.sh ,i ndare si me poshte**
 - Fondi limit per Cerdhet : 499.978 (kater qind e nente dhjete e nente mije e nente qind e shtate dhjete e tete) leke pa t.v.sh**
 - Fondi limit per Kopshtet : 599.952 (pese qind e nente dhjete e nente mije e nente qind e pese dhjete e dy) leke pa t.v.sh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2 dhe pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapacitetin profesional te operatorëve ekonomikë:

2.1.1 License/leje te leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL),sipas objektit te prokurimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për shitjen e lendes drusore dhe perpunimin e tij, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

2.1. Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin vitin 2023 (ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik dhuhet te paraqitet vecmas per secilin OE)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për per vitin 2019,2020,2021 ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 , ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqeruara me akt-ekspertizë të ekspertit kontabel, ku bilancet e **dy viteve të njëpasnjëshme**, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatimit Taksave).

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara,
 - Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjete transporti, të cilit do të shërbejnë për transportin e materialeve të pastrimit , me “masë maksimale të autorizuar” 3-3.5 ton, në pronësi të tij ose të marra me qera për transportin e mallrave objekt prokurimi. Kur është në pronësi të vertetohet me dokumentacionet: Certificate transport malli , leje qarkullimi, siguracioni i mjetit, kolaudimin, foto të mjetit .

Operatori ekonomik pjesmarres duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin kamion ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie.
- akt kolaudimi,
- policen e sigurmit te mjetit
- taksen vjetore
- lejen e transportit nga komuna apo bashkia per vete ose te trete.

Argumentimi: *Arsyeja përse është kërkuar automjeti eshte marre se malli qe do te dorezohet ne magazine e Drejtorise Cerdhe dhe Kopshte do te shperndahet ne gjithë kopshtet e cerdhet e njesise administrative te Bashkise Shkoder.*

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat vetjake si me poshte :

- Certifikate per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise EN ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente .
- Certifikateper Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit EN ISO 14001 – 2015 ose ekuivalente .
- Certifikate per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune BS OHSAS 18001 – 2007 ose ekuivalente .
- Certifikate per specifikimet per sistemin e menaxhimit te sigurise per zingjirin e furnizimit ISO 28001 – 2007 ose ekuivalente .
- Certifikate BS – PAS 99-2012 , ose ekuivalente .

Argumentimi: *Paisja me këto certifikata ISO, garanton qe OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm si dhe plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Operatori ekonomik ofertues për artikujt e tabelës së mëposhtme duhet të paraqesë :

- **Skdedat teknike të tyre**
- Në skedat teknike të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kerkuara me produktet e ofruara.
- *(Skedat teknike duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara).*
- Për Klorin leng (Hipoklorit Natriumi) dhe Klorin pluhur (Hipoklorit Kalciumi) duhet të paraqesë Raport Analize nga ISHP (Instituti i Shendetit Publik) , Raport analiza duhet të jete brenda 3 muajve nga data e hapjes se ofertave .

Nr	Emertimi
1	Solucion pastrim pllakash
2	Solucion pastrim xhamash
3	Sapun likuid duarsh
4	Solucion WC / Universal (Acid)
5	Zbutes rrobash (amorbidente)
6	Solucion lares enesh
7	Pluhur lares rrobash
8	Klor leng (Hipoklorit natriumi)
9	Klor pluhur (Hipoklorit kalciumi)

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor.

Mostrat e kërkuara do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorisë Qendrore dhe Kopshteve, adresa L.Perash, Rr.Skenderbeg, Shkoder.

Mostrat e kerkuara duhet te kene nje etikete e cila te permbaje elementet: moster “emri i artikullit”, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik.

Ditën e paraqitjes së mostrave, operatori ekonomik duhet te paraqese per secilin nga artikujt me mostrat edhe dëshmi te rezultateve te testimeve zyrtare, origjinale ose kopje të noterizuar (te leshuara nga institucione te autorizuara dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike).

Mungesa e mostres eshte kusht skualifikues.